



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

DRAFT
RREGULLORE PËR TRANSPARENCË KOMUNALE

Kaçanik, Maj 2011

Në bazë të nenit 11, nenit 12 pika 12.2 (c), nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L- 040, Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare, Udhëzimin e MAPL-së 2008/9 për Transparencë në Komuna dhe Statutin e Komunës nenin _____, Kuvendi Komunës miraton:

RREGULLORE PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

Neni 1

Qëllimi

Rregullorja ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legislative ekzekutive dhe administratës komunale gjatë ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësiive publike komunale, angazhimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel komunal, si dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumente zyrtare komunale.

Neni 2

Fushëveprimi

Përmes kësaj Rregullore rregullohet mënyra dhe kushtet për pjesëmarrjen sa më aktive të personave fizik dhe juridik në proceset që zhvillohen në komunë nga autoritet lokale, që përfshijnë:

- Pjesëmarrje aktive në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe organizmave të tij;
- Pjesëmarrjen në mbledhjet e ekzekutivit dhe trupave të tij;
- pjesëmarrje në mbledhjet e organizuara me publikun;
- pjesëmarrje dhe konsultimi para miratimit të akteve komunale;
- pjesëmarrja e publikut në procese tjera vendimmarrëse, si dhe
- qasje e lirë në dokumente zyrtare të komunës.

Neni 3

Përkufizimet

Përkufizimet në vijim kanë këto kuptime dhe shërbejnë për sqarime të kësaj Rregulloreje: “Seancat e Kuvendit të Komunës” - janë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës;

“Komitetet” - janë organizma ndihmës të Kuvendit të Komunës

“Pjesëmarrja e publikut” - do të thotë pjesëmarrja e qytetareve dhe grupeve tjera të interesit në proceset e vendimmarrjes të zhvilluara nga autoritetet lokale;

“Njoftimi i publikut” - nënkupton pasqyrimin e punës së autoriteteve lokale përmes formave të ndryshme informimit që përfshijnë: - tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin në mediat lokale, faqes zyrtare të komunës dhe forma tjera të ndryshme.

“Tubimet publike” - nënkuptohen tubimet e rregullta me qytetarë dhe grupe tjera të organizuara nga autoritetet lokale, me qëllim të njoftimit të qytetarëve me punën e organeve komunale dhe ngritjen e çështjeve të ndryshme nga qytetarët.

“Peticionet” - janë kërkesa kolektive me shkrim që i adresohen komunës respektivisht Kuvendit të Komunës nga një grup i qytetarëve apo grupe tjera të interesit për ndonjë çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë e komunës, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve që çojnë në zbatim të plotë të përgjegjësisë ligjore.

“Konsultimi publik i akteve komunale” – nënkupton marrjen e propozimeve nga qytetarët e komunës që shërbejnë për nxjerrjen e një akti të zbatueshëm në komunë.

“Qasje në dokumente zyrtare” – nënkupton te drejtën e qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit të kenë qasje të lirë në dokumentet zyrtare të komunës, në pajtim me procedurat e përcaktuara si Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

“Plani i veprimit për transparencë” – nënkuptohet krijimi i mundësive për publikun që të monitorojë në vazhdimësi punën e autoriteteve lokale në zbatimin e legjislacionit në fuqi, duke siguruar qeverisje efektive dhe të qëndrueshme.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Çdo mbledhje e Kuvendit të Komunës është e hapur për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik dhe subjektet tjera të interesuara.

2. Në çdo mbledhje Kryesuesi i Kuvendi të Komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim e njofton publikun të paktën 7 (shtatë ditë), para mbledhjeve të rregullta ose (tri) ditë, para mbledhjeve të jashtëzakonshme, njoftimi për publik bëhet përmes:

- Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- Faqes së internetit të komunës;
- Mediave të shkruara dhe elektronike; dhe
- Formave tjera.

3. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mundë të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

Neni 5

Mbledhjet e Komiteteve Komunale

1. Mbledhjet e komiteteve të Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe grupeve tjera të interesit.

2. Kryesuesit e Komiteteve Komunale nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun 3 (tri) ditë, para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin dhe rendin e ditës.

3. Të gjitha vendimet e komiteteve komunale, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumente zyrtare duhet t'i vihen në dispozicion publikut sipas kërkesës për qasje në dokumente zyrtare.

4. Komitetet Komunale mund të organizojë dëgjime publike me qytetarë dhe grupe të interesit për çështjet me të cilat merret komiteti përkatës.

Neni 6

Takimet e rregullta publike

1. Kuvendi i Komunës është i obliguar me ligj të mbajë dy takime me publikun gjatë vitit për çështje të interesit të përgjithshëm, po ashtu duhet të shqyrtojë mundësin për të mbajtur edhe takime tjera gjatë vitit, me qëllim që të jetë sa më afër qytetareve duke përfshirë edhe takimet që mund të zhvillohen në fshatra, vendbanime, dhe lagje, për të diskutuar për çështje të ndryshme.

2. Takimet e rregullta me publikun janë të hapura për opinion dhe përmes zyrës për informim duhet të bëhet:

- Afishimi i shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- Njoftimi i mediave të shkruara dhe elektronike; dhe
- Njoftimit përmes faqes zyrtare komunale

3. Të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku gjatë tubimit me publikun evidentohen dhe shqyrtimi i tyre nga autoritete komunale përgjegjëse bëhet në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh pas përfundimit të takimit.

4. Pjesëmarrja në takimet e rregullta publike e zyrtarëve të lartë komunal përfshirë Kryetarin e Komunës, Zëvendëskryetarin, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, është e obliguar.

Neni 7

Konsultimi paraprak i akteve komunale

1. Të gjitha aktet komunale përfshirë rregulloret, projekt-buxheti, planet, programet dhe vendimet e Kuvendit të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen në Kuvendin e Komunës.

2. Zyra përgjegjëse për informim e njofton publikun 14 ditë para seancës së konsultimit publik lidhur me aktin e propozuar.

3. Gjatë konsultimit me publikun, autoriteti lokal propozuesi i aktit merr pjesë aktive në konsultim, duke siguruar shpjegime të qarta për përmbajtjen dhe rëndësinë e aktit, si dhe është përgjegjës për të evidentuar dhe pranuar propozime që dalin nga konsultimi, dhe brenda një afati të arsyeshëm të shqyrtojë propozime që kanë rrjedhur nga konsultimi me publikun.

4. Organi propozues i aktit e informon Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës për propozimet e dhëna në diskutim publik. Kryetari i Komunës pas konsultimit me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës i propozojnë Kuvendit të Komunës që në tekstin final të aktit të përfshihen edhe propozimet e shqyrtuara paraprakisht dhe të cilat janë të argumentuara nga propozuesit.

Neni 8

Publikimi i akteve

1. Kryetari i Komunës, 7 ditë pas nënshkrimit të aktit me mjete financiare të Komunës vë në dispozicion të publikut aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.
2. Aktet komunale të nënshkruara dhe të përkthyer në gjuhët zyrtare në përdorim në komuna, vendosen në shpallje publike, media komunale, ueb faqe të komunës dhe forma tjera të publikimit që ekzistojnë brenda komunës, jo më vonë se 14 ditë pas nënshkrimit.

Neni 9

Peticionet

1. Çdo qytetar, organizatë ka të drejtë të ushtrojë peticion Kuvendit të Komunës për veprimtarinë dhe përgjegjësit e komunës. Peticionet duhet të drejtohen Kuvendit të Komunës dhe i dorëzohen Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Një peticion duhet të jetë i nënshkruar nga më shumë se 20 - 50 persona të regjistruar në listën e votuesve.
2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, çdo peticion të vlefshëm duhet t'ia paraqesë Kuvendit të Komunës brenda 30 ditëve nga dita e pranimit ose në takim të radhës së Kuvendit. Kuvendi i Komunës është i obliguar që t'i shqyrtojë peticionet dhe të marrë vendim brenda 6 javësh nga paraqitja e tij.
3. Me peticion të parashtruar mund të trajtohet secila çështje që është në interes të qytetarëve në kuadër të kompetencave të komunës.
4. Peticioni duhet të përmbajë emrat dhe mbiemrat e personave, adresat dhe nënshkrimet, si dhe objektin e çështjes që kërkohet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës.
5. Organizatori ose grupi mund ta merr fjalën në çdo takim të Kuvendit ose të ndonjë Komiteti ku shqyrtohet peticioni. Arsyetimi para Kuvendit apo Komitetit do të ishte një mënyrë e rëndësishme për të ndikuar në vendimin përfundimtar.
6. Kuvendi i Komunës brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni e merr vendimin. Vendimi i komunikohet parashtruesve të peticionit. Parashtruesit e peticionit në rast se janë të pakënaqur me vendimin janë të lirë të vazhdojnë të mbrojnë qëndrimet e tyre.

Neni 10

Qasja në dokumente zyrtare

1. Autoritetet lokale i sigurojnë dhe garantojnë çdo qytetari të ketë qasje në dokumente zyrtare komunale, përveç rasteve të cilat ndryshe parashihet me ligj.
2. Përgjigjet në kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare bëhen në afatin e përcaktuar me ligj.

3. Në rast se refuzohet kërkesa për qasje në dokument zyrtar komunal, atëherë organi komunal paraqet arsyet për refuzimin e plotë apo të pjesshëm të kërkesës dhe e njofton parashtruesin e kërkesës.

Neni 11

Dispozitat e fundit

1. Në të gjitha rastet kur ka kundërthënie të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe dispozitat e statutit do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe statutit.

2. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut

Nr. _____ datë, _____